

LORES – Inovacioni nga i cili do të përfitojnë fermerët shqiptarë dhe agrobizneset

Postuar më 14:48 - 25 Qershor 2015 nga Etleva Xhajanka në Ekonomi, Biznes dhe Finance, Lajme Nga Vendi



TIRANE, 25 Qershor /ATSH/- LORES- Sistemit Profesional i Referimit të Kredive, është inovacioni me i ri, nga i cili do të përfitojnë fermerët dhe agropërpunuesit shqiptarë për të aplikuar për më shumë financime në bizneset e tyre.

LORES, krijuar si pjesë e programit AgroKapital, të financuar nga USAID dhe zbatuar nga CBS, u zgjodh si një nga produktet inovative në sektorin bankar, mes shumë të tjerash të prezantuara nga banka dhe Institucione financiare të rëndësishme që veprojnë në vend si, Raiffeisen, BKT, ProCredit, Societe Generale dhe NOA.

Burime nga programi AgroKapital bëjnë të ditur se, sistemi po prezantohet nga përfaqësues të skuadrave të menaxhimit,

ekspertë të teknologjisë tek institucionet e linjës me qëllim zhvillimin e sistemit bankar në Shqipëri për kreditimin rural. Bujqësia shqiptare, një sektor me mundësi të mëdha zhvillimi, nuk arrin të përthithë vlerat e duhura të financimit. Aksesit në kapital dhe mungesa e njohurive teknike janë dy prej arsyeve kryesore që pengojnë përthithjen e fondeve. Sipas specialisteve, të jesh një hallkë e forte lidhëse mes bujqësisë dhe sistemit bankar nuk është një detyrë e thjeshtë. e.xh/ /a.ke/



DAP -Njotim per levizje paralele

